



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.210, datë 22.06.2021

PËR PEZULLIMIN NGA DETYRA TË PROKURORIT SALI HASA, PROKUROR NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR SARANDË

Bazuar në nenet 148/d pika 4 germa "a", 149 pika 1, 149/a, pika 1, germa "b", të Kushtetutës, në nenet 151 pika 1 germa "a", 155 dhe 156 pika 1, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në nenet 189, pika 1, germa "a", 164, pika 8 dhe 190, pikat 1 dhe 2, të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, nenet 4, 46 të Rregullores "Mbi funksionimin e komisionit disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve", miratuar me vendimin nr. 260 datë 17.11.2020, si dhe në shkresën e Prokurorisë së Posaçme, nr. 1368 prot., datë 22.06.2021, nëpërmjet të cilës njoftohen vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, nr. 40 datë 17.06.2021 dhe nr. 44 datë 21.06.2021, respektivisht për caktimin dhe vazhdimin e masës së sigurimit personal "arrest në burg" me propozim të Komisionit Disiplinor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Pezullimin nga detyra të prokurorit Sali Hasa, prokuror në prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për shkak të masës së sigurisë "arrest në burg" dhënë me vendimin nr. 40, datë 17.06.2021, dhe nr. 44, datë 21.06.2021, të Gjykatës së Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.
2. Pezullimi zgjat deri në rënien e shkakut për të cilin është vendosur ky pezullim.
3. Ky vendim i njoftohet Prokurorisë së Përgjithshme, prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë si dhe prokurorit Sali Hasa.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR

GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR

ALFRED BALLA





ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
ELOIDA GOXHI

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
MOISI DUDA

ANËTAR
TARTAR BAZAJ